



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draftaktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Njoftimi paraprak: 10 muaj

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike: 20 ditë pune, 02.11.2023 - 05.12.2023, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

a. Me shkresën nr. 746 prot., datë 13.02.2023, një njoftim paraprak i është dërguar nominalisht institucioneve si; Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Biblioteka Kombëtare Shqiptare, Akademisë së Studimeve Albanologjike, Shoqërisë së Librit Shqip, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Aleancës së Librit Shqip të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit në këtë projektligj. Me anë të shkresës së dërguar u prezantua nevoja për ndryshime dhe përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e librit dhe u kërkua të parashtroheshin pikëpamjet, idetë në lidhje me ndryshimet e mundshme. Nga ana e institucioneve të lartpërmendura nuk pati komente, sugjerime paraprake.

b. Konsultimi në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 02.11.2023 – 05.12.2023, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij protali, por në rrugë elektronike në adresën e e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin.

Aktivitetet e realizuara:

Shkurt 2023 - identifikimi i grupeve të interesit, përzgjedhja e metodave të konsultimit, nga struktura përgjegjëse për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë".

Shkurt 2023 - me shkresën nr. 3678 prot., datë 04.06.2022, ftohen grupet e interesit që të paraqesin:

- çdo informacion ose opinion paraprak për çdo çështje apo problematikë me të cilën janë hasur gjatë zbatimit të ligjit

- propozime konkrete për ndryshime në ligj me qëllim adresimin e këtyre çështjeve
- informacione ose opinione të tjera të tjera financiare apo të dhëna statistikore që vlerësojnë se i shërbejnë përmirësimit të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- 02.11.2023 – 05.12. 2023 Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i nënshtrohet procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrit elektronik për Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike”

Projektligji, relacioni shpjegues, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Më datë 24.11.2023 është organizuar takimi konsultativ nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, me përfaqësues të grupeve të interesit.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë:

- Qendra Kombëtare e librit dhe Leximit
- Ministria e Kulturës
- Biblioteka Kombëtare Shqiptare

Hartimi projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore. Projektligji është hartuar nga MK në bashkëpunim me QKLL dhe BKSH.

Projektligji i është nënshtuar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nëpërmjet të cilit nuk u përcollën komente.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten komentet e pranuar plotësisht dhe pjesërisht në lidhje me këtë projektakt:

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
<ul style="list-style-type: none"> Lidhur me shpërndarjen e librave drejt bibliotekave vendore dhe institucioneve të tjera publike. 	<ol style="list-style-type: none"> Gjykojmë se Neni 10 i projektligjit është i paqartë në mënyrën se si është shkruar dhe, për mendimin tonë, do duhet të rishkruhet sepse lë vend për keqkuptime. Lidhur me Nenin 16, BKSH shpreh mosdakordësinë e saj me pikën 2, përse më poshtë: duke sugjeruar që shpërndarja e këtyre librave të bëhet në bashkëpunim me bashkitë, të cilat kanë në vartësi bibliotekat publike të qyteteve, ku do të shkojnë këto libra. 	Biblioteka Kombëtare	Pranuar pjesërisht	Në vlerësim të komentit nr.1 të BKSH komenti është marrë parasysh dhe është reflektuar me riformulimin e nenit 15. Komenti nr.2 nuk është marrë parasysh pasi sqarojmë se BK si institucion përfitues i librave nuk mund të mos jetë dhe autoriteti përgjegjës për shpërndarjen e tyre, në projektligj është përcaktuar qarët se BK shpërndan kopjet e tjera në institucionet publike, në bazë marrëveshje të nënshkruar mes palëve, në marrëveshje do të përcaktohen modalitetet e shpërndarjes së librave në bashkëpunim me institucionin përfitues.
Pjesëmarrja në KKLNL dhe mbështetje në fushën e përkthimeve.	<ol style="list-style-type: none"> Në ligjin e ri të përcaktohet që në Këshillin Kombëtar të Librit që të jetë anëtare edhe Shoqata e Përkthyesve Shqiptarë. Mendojmë që kjo do ta pasuronte këtë këshill me mendime e propozime nga kjo Shoqatë. Të shihet mundësia që tarifa prej 15% 	Z. Rexhep Hida,,Kryetar i Shoqatës	Pjesërisht është i reflektuar në projektligj	Vlerësojmë se komenti nr.1 gjendet i reflektuar në projektligj pasi në nenin 8 parashikohet se pjesë e KKLNL do të jenë edhe 2 anëtarë nga grupet e interesit ku rast pas rasti do të jetë edhe shoqata e përkthyesëve për shkak të numrit të lartë të grupeve të interesit. Komentet nr.2,4,5 nuk mund të gjejnë reflektim në këtë projektligj pasi i përkasin rregullimeve të tjera ligjore. Gjithshtu të

	<p>për përkthyesit të ulet në masën 8-10%.</p> <p>3. Të shikohet mundësia që për Shoqatën e Përkthyesve Shqiptarë të jepet mbështetje financiare që është e domosdoshme për shpenzimet për një mjedis, për dhënie Çmimesh për përkthimin si dhe për veprimtari shkencore me rastin e Ditës Botërore të Përkthimit etj. si seminare, simpoziume, workshop-e, e pse jo edhe mbajtjen e një Kongresi të përkthimit.</p> <p>4. Të shihet mundësia që të ulen tarifat postare.</p> <p>5. Të hiqet TVSH për librin.</p>			<p>njëjtat komente janë përcjellë edhe nga Instituti për Kulturë dhe Edukim për Zhvillim për të cilat vlen i njëjti qëndrim.</p> <p>Për sa i përket komentit nr. 3 sqarojmë se Minsitria e Kulturës dhe institucionet në varësi të cilat zbatojnë politikat në fushën e librit kanë në fokus mbështetjen e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimin e veprimtarive kulturore dhe artistike përfshirë dhe fushën e përkthimit, rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike. (I njëjti argument qendron edhe për komentin nr.2 më poshtë)</p>
--	---	--	--	--

<p>Propozime për ndryshime në baza të tjera ligjore</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosjen e normës TVSH 0% për e-books dhe librin digjital për një periudhë 5-10 vite. 2. Mbështetjen me grante dhe forma të tjera të botuesve, distributorëve, librarëve, start-up-ve që punojnë në tregun e librit elektronik. 3. Ndryshimet ligjore dhe rregullative për librin elektronik. 4. Vendosjen e ISBN-së për librin digjital dhe elektronik. 5. Rregullimin e kalatogimit CIP, kategorizimin, Identifikuesi Unik Universal, depozitimin e kopjeve elektronike tek BKSH, dhe bashkëpunimin e operatorët e interesit për aksesin në e-books që të minimizohet pirateria. 6. Marrjen e masave për Menaxhimin e të Drejtave Elektronike. 7. Përmirësimin e procedurave për tenderimin e librave nga entet publike. 8. Mostjetërsimin e fondeve të librit nga entet publike. 9. Njehsimin e normës së TVSH-së për librin mes Shqipërisë dhe Kosovës. 10. Heqjen e taksës doganore me Kosoven për librin. Ne pamundesit, të zgjatet afati i pagesës së kesaj 	<p>Instituti për Kulturë dhe Edukim për Zhvillim përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z.Albert Gjoka</p>	<p>Komentet pjesërisht kanë qenë të reflektuara në projektligj</p>	<p>Komenti nr.1,5,6,7,9,10,11,12,13,15, 17,18,19 , nuk mund të reflektohen në këtë projektligj pasi i përkasin rregullimeve të tjera ligjore. Komenti nr. 3 ka qenë reflektuar në draft, duke parashikuar edhe librin në format elektronik.</p> <p>Komenti nr.4 mbi vendosjen e ISBN, sqarojmë se ISBN është pjesë e parashikimeve në ligj Nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit përcaktohen procedurat për ofrimin, dhënien dhe kontrollin e zbatimit të ISBN-së, si dhe kushtet që duhet të plotësojë botuesi për kërkimin, marrjen dhe vendosjen e ISBN-së.</p> <p>Për sa i përket komentit nr.14 sqarojmë se projektligji ka parashikuar edhe në objekt edhe në qëllim promovimin dhe nxitjen e leximit e cila do të sjellë zbatimin e programeve që do të përmbushin këtë koment.</p> <p>Komenti 8, 16, dhe 19 ka qenë i reflektuar në projektligj, regjistri i ka kaluar QKLL dhe në përbërjen e KKLNL do të jenë edhe 2 përfaqësues nga grupet e interesit.</p>
---	---	--	--	--

	<p>takse ne varesi te procesit te shitjes se librit apo kthimit, sipas marreveshjeve qe kane operatorët ne dy tregjet e librit.</p> <p>11. Rritjen e kufirit të pakos së librave në 70 – 100 euro, pa taksë doganore, kur transportohet nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas</p> <p>12. Heqjen e TVSH-së për transportin e librave nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas</p> <p>13. Vendosjen e çmimeve të përbashkëta vjetore letrare mes Shqipërisë dhe Kosovës për letërsinë e shkruar në gjuhën shqipe, qoftë për fëmijë apo të rritur</p> <p>14. Pasurimin e ndërsjelltë të bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë, duke rishikuar listën e rekomandimeve, duke futur edhe nga autorë nga Kosova si pjesë e librave të rekomanduar.</p> <p>15. Ndryshimin e skemës aktuale të normës së TVSH-së, pa ndryshuar nivelin fundor 6% tek lexuesit, duke dhënë ndihmesë jo vetëm për botuesit, por edhe për distributorët dhe libraritë. Kjo ndërhyrje do të ndikojë që të ulet çmimi për lexuesin, të rriten shitjet dhe, për rrjedhojë, edhe lexueshmëria</p> <p>16. Regjistri i botuesve të kalojë në varësinë e</p>			
--	--	--	--	--

	<p>QKLL duke përmirësuar punën e tij, rritur formalizimin dhe vendosur kushte për botuesit që të kenë redaktorë dhe korrektorë të punësuar.</p> <p>17. Rregullime të mëtejshme sipas Ligjit për Sponsorizimet, ku subjektet publike dhe private që paguajnë tatim fitimi, japin 5% të shumës së tatimit si mbështje për botuesit.</p> <p>18. Të shpallet me ligj ose vendim Dita Kombëtare e Librit, përmes të cilit të synohet të promovohet libri dhe leximi me një kalendar të ngjeshur aktivitetesh dhe çmimesh.</p> <p>19. Propozohet data 5 janar si dita e botimit të librit të parë në shqip, Mesharin e Gjon Buzukut.</p> <p>20. Të përfshihen të gjithë faktorët e grupit të interesit në institucionet politikbërëse dhe vendimmarëse për librin, - si palë që nga libraritë, distributorët, autorët, përkthyesit dhe grupet e lexuesve.</p>			
--	---	--	--	--